

PODCAST: MARSHI I GRAVE BUKË PËR DRENICËN

[Ekstraktet nga intervistat sjellin përvoja dhe kujtime të grave që organizuan dhe morën pjesë në marshin Bukë për Drenicën. Intervistat e historisë gojore u zhvilluan midis viteve 2012 dhe 2023.]

Organizimi

Edita Tahiri: Në periudhat kur situata eskaloj në Kosovë, kur dhuna serbe filloi të përshkallëzohej në masa të paparashikueshme, ne organizuam disa protesta, në mesin e tyre është Marshi i Bukës, me të cilin treguam solidaritetin ndaj Drenicës e cila ishte e rrethuar. Një protestë që arriti të ndërkombëtarizoj çështjen e eskalimit të luftës në Kosovë. Nuk ka qenë ad-hoc sot për sot, dikun me sa më kujtohet një javë kanë qenë përgaditjet e çdo ditë jemi takuar.

Nazlije Bala: I maj në mend sikur sot qenë një grup jo shumë i madh, një grup kemi qenë shumë i vogël i grave që kemi organizu marshe dhe protesta të ndryshme në Kosovë. Them marshe dhe protesta të cialt kanë ditë vërtetë ta tronditin botën, ta shkundin botën. Ku kemi arritë mbi treqind mijë gra t'i mbledhim në Prishtinë dhe të organizojmë marshin për Drenicën. Kuptohet që ky marsh nuk e ka arritë cakun e vet që të shkojë vërtetë në Drenicë se u ndalëm në rrugë. Por ka arritë ta ngrehë zërin, jo ta vetëdijësojë, por vërtetë ta ngritë nga gjumi bashkësinë ndërkombëtare mbi vrasjet dhe masakrat të cilat ndodheshin në atë kohë në Kosovë.

Flora Brovina: Dhe ashtu në mramje m’kishin thirrë shumë njerëz, “A vërtetë po mendoni me shku në Drenicë? A mundeni? A guxoni?” Kishte kësi. Nuk them se nuk do të shkonim, por mbas Fushë Kosovës ndodheshin autobusët vullnetarë që i kishin organizu e që do t’i bartnin këto gra. Pra, ne do të shkonim domosdo. Dhe pse u nisëm, ku ishte motivi? Sepse atëherë kishte fillu ni terror ndaj popullatës shqiptare; i merrshin gratë, i veçonin prej burrave, i fusnin nëpër shkolla fmitë dhe gratë pa ushqim, pa trajtim mjekësor, kishte në mesin e tyre gra shtatzana dhe ishte shumë ni atmosferë acaruese pse na u nxitëm ta bojmë këtë.

Lindita Cena: Domethonë në fillim të marsit [1998] të gjithë e dijmë edhe të gjithë e kujtojmë masakrën në Prekaz në familjen Jasharaj. Aty ka qenë ajo periudha kur ata u bllokuan, domethanë nga forcat serbe dhe nuk kishin mundësi që të siguronin as ushqim ose barnat elementare për të cilat kishin nevojë masi ishin të rrethuar nga forcat serbe. Tani, nëse nuk gabo, ka qenë Forumi i Grave i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ku bënë thirrje për mobilizim dhe tubim të sa më shumë femrave, grave, vajzave, që të paktën me i dërgu nga një bukë edhe barnat elementare atyne njerëzve që kanë mbetur të bllokum në Prekaz.

Florina Duli: Unë mendoj që shumë ka pasë spontanitet te organizimi... po mendoj këto, organizimi i protestave me letër të bardhë, organizimi i protestave me bukë. Ato nuk kanë qenë shumë të... shumë kështu naive me qenë se në atë kohë veç filloi njëfarë *shuttle diplomacy* me Kosovë. Vëshin, domethënë e panë bota që ktu po ndodhë diçka, sidomos me ardhjen e “Medieve pa kufi” të cilët raportojshin për situatën e të drejtave të njeriut, që ishin tash burime shumë ma të besueshme se që ish Këshilli i të Drejtave të Njeriut e LDK-ja, meqenëse ishin ndërkombtarë. Jo ishte Kryqi i Kuq Ndërkombtar, jo Federata e Kryqit të Kuq Ndërkombtar, Organizatat e Kombeve të Bashkume edhe pse s’kanë qenë shumë, shumë edhe konstruktive në atë kohë në raport me shqiptarët. Por, sidoqoftë ka pasë një lloj depërtimi të të huajve në Kosovë edhe interesim të shtum të mediave ndërkombtare në Kosovë. Prej vitit ‘90 - ‘91 e tutje ka pasë gazetarë që rregullisht e kanë përcjellë situatën në Kosovë.

Tani qato kanë ndodh, domethënë gratë kanë qenë gjithmonë të konsiderume si... domethënë një protestë e grave është konsideru shumë ma e parrezikshme për gratë që marrin pjesë, në krahasim me një protestë ku marrin pjesë burrat për shkak që domethanë gratë janë pa gjithmonë si ma paqësore, ma të pa rrezikshme, që nuk marrin armë me veti, që nuk shkaktojnë trazira. Kështu që, qajo ka qenë domethënë. Protesta e parë ka qenë me letra, e dyta ka qenë me bukë për nanat edhe fëmijët e Drenicës. Ajo protesta me bukë ka qenë në kohën kur faktikisht Drenica ka qenë totalisht e izolime prej pjesës tjetër të Kosovës, edhe brenga janë kryesore ktu që ishim, domethënë njerëzit në Prishtinë ishte si të qasen, domethënë sa munden m’u furnizu me ushqim? Si mujn me ardhë gratë që kanë terminin e lindjes, për shembull me ardhë me lindë jashtë Drenicës? Se aty s’kish kurrëfarë shërbimi shëndetësor, çka bojnë njerëzit që janë në dializë? Edhe na krejt këto gjana i kemi diskutu shumë gjatë me organizata ndërkombtare, mes vete, për me mujt me bo njëfarë sensibilizimi ma të madh për me u organizu kjo protesta me bukë edhe jemi nisë për drejtim të Drenicës.

Albertina Ajeti Binaku: Domethonë sipas RTP-së në atë kohë, edhe sipas shtypit ditor është marrë vesh që në atë kohë në Drenicë jonë të rrethekum familjet, nuk kanë ushqim, nuk kanë qasje. Ka qenë një mobilizim i përgjithëm në atë kohë i krejt popullsisë në Kosovë. Edhe gjatë muhabetit, “O osht’ një protestë nesër, për këtë arsye, për këtë arsye...” Edhe osht’ vendosë që të protestohet në mënyrë paqësore, të mirrët një bukë në dorë edhe me atë bukë të nisemi për në Drenicë, me qëllim që atë bukë të ja u dorëzojmë familjeve të cilat kanë qenë të rrethekuara nga forcat serbe në atë kohë. Nuk ka qenë tendenca me i jap konotacion politik. Ka qenë më tepër me jap konotacion humanitar, sepse familjet me ditë të tana, me javë të tana ka qenë të rrethekuara. Nuk kanë pasë lëvizje të lirë, domethonë me dalë më u furnizu me ushqim e me gjana tjera. Edhe kjo ka qenë. Domethonë ne, si nana, si femra, me bashkëndje me nanat në atë kohë në Drenicë, të cilat nuk kanë pasë ushqim për fëmijët e tyre. Edhe në anën tjetër ndoshta me apelu tek autoritet e atëhershme që me i leju ndihmat humanitare, ushqimi, veshëmbathjet, çkado që kanë pasë nevojë, me, me, me ju jap mundësia që ndihmat me pasë... me hy në fshatna edhe me pasë qasje për ata që kanë pasë nevojë.

Mevlyde Mezini Saraçi: Na u nisëm sepse ishte ni pikë qendrore të takohemi në Prishtinë edhe të nisemi për Drenicë. E tani nisja jonë duhej të bëhej nga Prishtina. Na u nisëm, neve na ndaluan në Gjakovë në hyrje. Ishim të organizuara me ni makinë edhe sapo na ndaloi policia... ata i dinin lëvizjet tona dhe kishin marrë ni informatë që do të ndodhë nisja me bukë. Domethonë, çdo aktivitet që kemi bërë jashtë Gjakovës në mënyrë të organizuar janë munduar të na shtypin. Por që fatkeqësisht në Drenicë na nuk kemi mbri të jem askush nga Gjakova, sepse na ndaluan që në fillim.

Teuta Bekteshi: Ka qenë ni problem atëherë se na e organizum me bo ni protestë me iu bashkangjitë protestës së grave në Drenicë. Ne në Kumanovë, ishte shumë problematike me u organizu, dhe ne e bamë në një shkollë bisedë, një shkollë që është këtu “Naim Frashëri”, me drejtorin e asaj shkolle edhe që ta organizojmë na, jo në rrugë se në rrugë nuk linte policia, po ta bëjmë në kuadër të shkollës, a po kupton? Që brenda në hapësirë të mbyllur ta bëjmë protestën. Çka ka ndodhë? Do të thotë, i kemi organizu krejt fshatrat, vajzat, me recitime me sende, me këto që i kishim mbledhë na që ta bojmë ni protestë, secili t’i bashkangjitemi. Por, ish një problem se mu në 11:00 të natës mu më janë lajmëru prej policisë. Edhe tha, “Ti e ke organizu,” domethonë, “ti e ke bë këtë organizim”. Por nuk ish problemi që na e kishim bo këtë organizim, po ata bënë presione te shkolla dhe shkolla në 12:00, në 1:00 të natës dolën me informacion drejtorja e shkollës se është anulu, pa na lajmëru neve fare, a po më kupton? Që është anulu protesta, pa na pytë neve fare domethanën. Dhe atëherë ka qenë një tollovi e madhe, u patëm revoltu shumë na, e bomë, erdhën të fshatrave, u mbledhën e, po nuk bëm ndonji protestë të organizume them, po ishte kjo si sporadike, një reagim ma shumë pjesë-pjesë, a po më kupton? Nji organizim qysh e kishim planifiku na.

Bukët

Igballe Rexha Jashari: Buktë i sillnin, domethonë, absolutisht, veç kur i shihshe me qese të gjithë furrtarët, domethonë që... solidariteti ishte maksimal, maksimal ishte. Atë që dikush e kishte ose dikush që mendonte që është në shërbim apo në të mirë të përgjithshme, domethonë pa hezitim secili e bonte, edhe shpërndarja... buktë veç kur e shishe që vishin edhe sa nuk u dashin, domethonë, aty. Secila, kur tham që me bukë do të organizohemi, domethonë edhe kanë ardhë gra prej pjesëve të ndryshme domethonë te furra janë furnizu me qese të bukës, domethonë edhe ka pasë mjaftueshëm për të gjitha gratë pa hezitim bukë. “Bukë për Drenicën” domethonë që ishte, kishte fillu lufta, ishte ni faktikisht ni zonë ma e izolume prej tjerave që bahej lufta.

Edita Tahiri: Në fakt kur kemi diskutuar unë, Sevdija dhe Edi, kemi pasë disa idena. Ka pasë idena që të përdoret ndonjë element që e karakterizon gruan, por analizat e ndryshme na çonin në përfundim se s’do të duhej ta bëjmë për të identifikuar gratë, por ta bëjmë për ta identifikuar qëllimin. Qëllimi ishte pra mungesa e ushqimit, barnave, e gjërave higjienike, kështu që prej këtyre të triave na u dukë buka me një simbolikë më të fuqishme dhe me efekte më të mëdha. Dhe kështu kemi ardhur deri te ky përfundim. Ai ishte një organizim shumë i madh pastaj, siç ju tregova LDK-ja ka qenë e organizuar në gjithë Kosovën. Furrëtarët ishin pjesë e lëvizjes, kështu që të gjithë këta ishin aktivista dhe lehtë ishte që të trokasim në dyert e furrtarëve që të... edhe e përcaktum numrin. Pastaj, meqë nuk arritëm të depërtojmë deri në Drenicë shkaku i pengesave, ne nuk e mbyllëm protestën aty, shkuam tek, në atë kohë ishte jo Ambasada Amerikane por përfaqësia Amerikane ishte hapur në vitin, në janar të ‘96-tës, dorëzuam një letër me të cilën kërkuam angazhime ma të shtuara të Amerikës. Pastaj shkuam tek furrat dhe i kthyem bukët.

Vjosa Dobruna: Duhna me e pranë që ideja ime ka qenë që të mos shkojmë vetëm me një bukë kur u mbyll Drenica, po të shkojmë edhe me një paketë të peceve higjienike, t’i kemi. Por pasi që gratë e partive politike kanë bisedu, të nesërmen para se me u nisë erdhën, “Jo, nuk bon.” Se na shkumë me ble peca higjienike... “Nuk bon, nuk bon!” Se, me folë për seksualitetin ose për reproduksion, ose diçka të grave, ishte gati e turpshme. Prandaj, nuk na lejunë, u kriju nifare atmosfere që u mendohke që nëse e bëjmë protestën si të tillë, do ta tërhekim vëmendjen prej qëllimit primar që osht’ me liru mbylljen e Drenicës që ish bo.

Florina Duli: Unë për veti e kom ble edhe mendoj që secili i ka... ka pasë edhe kanë shpërnda furrat kanë pru bukë me asi, por ka pasë edhe shumë të tillë që e kanë ble kur janë nisë prej shpie, meqenëse e kemi ditë që kemi me... nuk mundeni me marrë me mend nivelin e solidaritetit që ka qenë në atë kohë, osht’ i pa përshkrushëm. Domethone, atëherë as nuk e ke mendu atë pjesën materiale të angazhimit në asnjë moment, gjithëmonë ka pasë. Tash kur e mendojmë për iniciativa mendojmë ku do t’i marrim paret për një baner, për një kështu, për ashtu. Atëherë ka qenë shumë, shumë spontane edhe pjesa ma e vogël e brengës ka qenë ajo ku kemi m’i marrë mjetet për me organizu diçka, se krejt

kanë ardhë, ka pasë shumë, shumë solidaritet mes njerëzve, por edhe investim vetanak të njerëzve në çkado.

Flora Brovina: Marshi ishte mendu pak ma ndryshe nga disa shoqe, fjala ma feminist, por mu nuk ma merrte mendja ashtu, s'po di s'po e them këtu. Për shembull, të kemi edhe gjana higjienike dhe kjo nuk shkonte, për mentalitetin tonë nuk shkonte. Prandaj mjaftonte që të shkojmë me bukë dhe ndoshta ndonjë gazë ose diçka, por jo ashtu.

Lindita Cena: Bukën e kemi marrë msheftas se ata, faktikisht protesta edhe ka qenë e paralajmërime, ata e kanë ditë se na, qëllimi për çka po shkohet në Prekaz. Po është dashtë me pritë me u bo terr ose ndonji furrë që e kemi pasë të njoftun ose dikush tjetër na i ka siguru, edhe secili e kemi pasë për detyrë që me pasë, masi simbolika ka qenë me bukë në dorë për Drenicë. I kemi siguru ashtu qysh kemi mujt, në mënyrë të msheft ose pa u vërejt. Unë e kam siguru përmes pronarëve të banesës ku unë kam jetu. Domethanë, përmes atyre, prej atyre e kam kërku një bukë me ja u huazu.

Marshi

Florina Duli: Kur jemi nisë valla kemi mendu që kemi me mbërri edhe pse deri sa u bonëm grupi, e deri sa u mbledhëm e asi ka qenë shumë e lodhshme, se jemi mbledhë qaty ku osht', ka qenë përpara që i thojshin stacioni i vjetër trenit, afër zyrës amerikane jemi nisë në drejtim të Fushë Kosovës edhe normalisht që s'na kanë lonë me... E di që na kanë ndal bash tash ku osht', nëse më kujtohet mirë tash ku osht' Deloitte, ku osht' Ambasada Britaneze në Fushë Kosovë, atëherë s'ka qenë autostradë, ka qenë vetëm rrugë magjistrale. Na kanë dalë policia edhe faktikisht në marrëveshje me udhëheqsinë u dashtë, kemi vendosë që duhet me u kthy se nuk e vlente barra qiranë, se nuk ish punë që ti rezistojsh edhe mupshe me i rezistu deri në Drenicë. Ajo hecja nuk ish thjeshtë qëllimi përnime për me i çu bukët në... domethënë efekti që e kish medial për bashkësinë ndërkombëtare ma shumë, kështu që aty jemi kthy. Nuk më kujtohet shumë ajo pjesa a kanë përdorë gaz lotësjiellës apo jo, se e kom shumë të megjullt atë...

Gjylshen Doko Berisha: Unë e mbaj në mend atë protestë, vajtjen time në Prishtinë dhe të grave të tjera prej Gilani, por që si organizatore kam shku ma herët, të tjerat kanë ardhë në forma të ndryshme, me vetura private apo me autobus dhe nisjen tonë aty. Fillimi ka qenë, unë kam qenë përpara, fillimi ka qenë të shohim a do të kemi disa hapa, a do të kemi ndonjë pengesë. Kemi vazhdu prej zyrës amerikane, kemi vazhdu në rrugën kryesore, atëhere [kemi pasur] përcjellje normal. Ne gratë kemi marshu, nuk kemi kërku ndihmë prej burrave por ata kanë ndejt anash, megjithatë për çdo rast. Dhe vërtetë kemi dashtë që të mbetet protestë unike.

Lindita Cena: Protesta ka qenë e organizime për datën 16 mars, 1998. Nisja është parapa të bëhet nga Dragodani te Ambasada Amerikane, aty është mbledhë një numër shumë i madh i vajzave, grave, të cilat... secila e kishim nga një bukë në dorë dhe barnat që me shpresë që me shku me, me iu dërgu familjarëve që kanë mbetë të bllokum në Prekaz. Qysh në fillim, domethonë qysh në tubim ka pasë provokime nga njerëz të ndryshëm. Por na nuk jemi ndalë. Domethonë, fillimisht marshi ka fillu nga Dragodani edhe dikur kur kemi mbërri knej ka Fushë Kosova, afër Shkollës Bujqësore aty, domethonë përgjatë gjithë rrugës na kanë përcjellë njerzët me vetura, me regjistrimet serbe. Edhe na kanë provoku, kanë bërtitë, janë mundu me na frikësu ose me na... po na s'jemi ndal, kemi vazhdu rrugën tonë, as që kemi bërtitë, po e kemi ditë qëllimin për çka jemi duke shku atje.

Albertina Ajeti Binaku: Edhe e di që kemi hecë prej qendrës, saktësisht tash s'po më kujtohet. Mirëpo, kemi vazhdu deri te, atëkohë ka qenë "Show Restaurani", tash osht' UN-i, ku osht' "Jysku" tash, qe qaty na kanë kthy. Edhe pjesëmarrja ka qenë e madhe, ka pasë shumë gra. Dhe e mbaj në mend që në rend të parë kanë qenë, domethonë n'atë kohë.... Kemi majtë bukën në dorë naltë ashtu si në shenjë proteste, domethonë, "Lejoni, kanë nevojë për ushqim fëmijët, nanat, familjet".

Edhe e di që kemi qenë si, domethonë ka qenë si kolonë edhe anash kanë qenë forcat policore. Deri sa kemi mrrri në atë pikë, mandej nuk na kanë leju me shku ma tutje. Kanë kërku me negociju, mirëpo nuk kanë qenë të gatshëm. Ashtu në mënyrë, me fjali urdhërore na kanë thanë, "Duheni mu kthy, përndryshe nuk mujmë me rreziku sepse mandej mundet me ju ndodh diçka, s'mujmë me ju mbrojtë..." Mirëpo, nuk na kanë lanë më shku. Domethonë deri te ajo pjesa, tash ku osht', ku jonë ato qendrat tregtare në rrugë për Fushë Kosovë, aty na kanë ndalë edhe na kanë kthy. Ka pasë forca të mëdha policore.

Nuk kemi... edhe mandej të them të drejtën në atë kohë gratë të cilat jonë marrë me oragnizime të tilla, e di që jon konsultu edhe mandej bashkarisht kemi vendosë për me u kthy në Prishtinë. Po e di që ka qenë një ditë e zyrtë, e ftoftë, me shi edhe që gra ka pasë shumë, po edhe forca policore ka pasë shumë. Burra nuk ka pasë. Une sa, sa e mbaj n'mend burra nuk ka pasë. Edhe osht', iniciativa kur na osht', kur kemi diskutu edhe na osht' spjegu... domethonë, prapë po kthehem, sepse me pas pasë burra nuk e kishte mrrri atë efektin që dojshim na me mrrri në atë kohë. Domethonë që na jemi nana, jemi femra, nuk kemi të bëjmë më politikë, osht' çështje humanitare. Po kanë qenë vajza të reja, kanë qenë ma të moshume, domethonë demografia ka qenë e ndryshme. Mirëpo, mashkuj nuk ka pasë, kemi qenë krejt femna.

Flora Brovina: Po megjithatë u takum të gjitha bashkë dhe duke e përdorë përvojën e Lidhjes të Grusë. Gratë e Lidhjes të Grusë ndodheshin në Drenicë realisht atë ditë, vetëm disa aktiviste ndodheshin në Drenicë, ndërsa ne ndodheshim këtu shumica dhe unë si udhëheqëse.

Albertina Ajeti Binaku: E mbaj në mend në rendin e parë edhe t'dytë kanë qenë gratë të cilat kanë qenë domethonë pjesë e LDK-së. Edhe kur kemi mbërri te, domethonë ajo pjesa ku ka qenë policia.

Forcat policore, e di që kemi tentu, kemi pritë muj me thonë gjysë ore, 45 minuta që me na lëshu me vazhdu ma tutje. E mbaj në mend që ato kanë negociju. Mirëpo, nuk na kanë leju për me vazhdu. Ushtri nuk ka pasë, unë sa e mbaj në mend ka pasë policë. Shumë policë ka pasë. Ushtri nuk mbaj në mend që ka pasë. Definitivisht ka qenë kërcënim. Nuk osht', nuk kemi pa një, domethonë një mirëkuptim prej anës të tyre. Ka qenë definitivisht kërcënim edhe qasja e tyre, mënyra se si jonë shprehë, si kanë bisedu, po menoj me përfaqësueset edhe organizatorët e protestës, nuk ka qenë ashtu të them pozitive edhe me, me insistu na që me vazhdu më tutje. Ka qenë kohë, kohë pa kohë ka qenë.

Ajnishahe Azemi: Unë kam qenë ju thashë në rendin e parë, aty kanë qenë të gjitha shoqet, ka qenë Edita e këto. E në rendin e parë kam qenë, para policisë. Ka qenë ju thashë shumë randë, po u bohshim krenar se ishim, qëndronim, represioni e këto, ti e dishe që je dalë po nuk e dishe a po të majnë a po të maltretojnë ty apo shoqen tande apo dikon tjetër edhe çdonjeri ka mujt me pësu ashtu...

Edita Tahiri: Ne pjesa që ishim duke u marr aktivisht me procesin e pavarësisë e të çlirimit i kemi pasë parasysh edhe pengesat. Mirëpo, kemi qenë të vetëdijshëm që vetë protesta do të jetë një manifestim me efekte të mëdha, sepse mesazhi shkoi në gjithë botën. Madje, kur filluam të konfrontohemi me policinë serbe, unë fola anglisht sepse me atë e dërgova mesazhin në botë. Derisa disa që ishin afër folën shqip dhe serbisht, unë fola anglisht. Pse anglisht? Sepse bota duhej të kuptojë çfarë mesazhi kemi, jo policët serbë, sepse ata ashtu-kështu e kishin vendosë të na pengonin.

Gjylshen Doko Berisha: Kur jemi afër te hyrja e Fushë Kosovës, kordoni i policisë i armatosur deri në dhëmbë na ka ndalur edhe kanë thënë, "Ju nuk mund të vazhdoni më tutje!" Atëherë e ka marrë fjalën Edita Tahiri, e njihte mirë gjuhën angleze edhe ka komunikuar në gjuhën angleze me policinë. Fatmirësisht atëherë mediat i kemi pasë ndërkombëtare këtu, është përcjellur lajmi dhe ka bërë bujë mjaft e madhe.

Flora Brovina: Në grupin, në rendin e parë ju do t'i shifni kush janë, ne jse s'ka rëndësi kush janë, unë kisha ni detyrë tjetër dhe nuk e di këto të rendit të parë, bashkorganizatorët a e dinin se deri në fund si është e organizune shkumja në Drenicë. Ne kishim organizu kontrollën që të na tregojë për rrezikun në çdo fazë, për shembull ku na pret patrulla, ku rrezikohemi dhe çdo moment vinin informatorët. Unë isha në qosh, domethanë isha në ballë por në qoshe dhe plus asaj kisha ni kapele për mbrojtjen e flokëve dhe mantilin e bardhë për shkak që me më njoftë informatorët. Informatorët ishin edhe në lëvizje me veturë, por ishin edhe në radhë.

Njëra prej aktivisteve tona shumë punëtore me të cilën kishim punu edhe në teren, Nazlie Balaj, e kishte marrë përsipër ni detyrë shumë të randë. E kishte marrë përsipër me disa shoqe që ta rregullon rendin, domethanë që të mos ecim pa rend, me ni fjalë policin e komunikacionit. Me ni shirit na e mbanim rendin që të tregohemi edhe shumë civilizuese dhe kujtoj që këtë detyrë e ka kry shumë me nder.

Por në mesin e aktivisteve mbrapa, mbrapa nesh ndodheshin aktivistet e vërteta, ato që e njëfishin edhe terrenin. Ne vetëm simbolikisht do t'i përfaqësojmë subjektet tona ndonjëherë edhe jo proporcionalisht, por jo proporcionalisht kur them e them me plot gojën dhe e di çka po them. Në një moment dy studente, kur ndodheshim pak para urës, dy studente në Dardani tu shku kah Fushë Kosova, dy studente erdhën afër meje. S'ishte hera e parë që po më informonin se një veturë e bardhë po kalon vazhdimisht; është e policisë, por e dija këtë informatë. Dhe në një moment derisa njëra po më tregonte diçka dhe tjetra ishte afër, vetura erdhi nga ne dhe na ra. Këto dy studentët ranë për toke, unë qëndrova, por më ranë këtu te kamba dhe kam pasoja prej lëndimit, por unë nuk rash.

Shpejt e shpejt këto vajzat... erdhi vetura tjetër e jona i mori dhe i çoi në spital. Më pytën, "Si je?" "Mirë" thashë. Nuk tregova dhe të drejtën me thanë në atë të nxehtë nuk më dhimti shumë kamba. Pastaj vazhduam deri te ura, na rrethoi policia, kisha informatën nga këto dy vajza që populli i Fushë Kosovës që ishin me përqindje ma të madhe serbë, janë përgatitë të na vrasin, janë përgatitë me gurë, janë përgatitë me armë që kanë dalë në të dy antë e rrugës dhe do të bohet masakër. Atëherë, në këtë moment e kisha dilemën a guxoj, a është mirë t'i sakrifikojmë gratë me gjithë atë vullnet që e kanë?

Lindita Cena: Në moment nuk e mbaj mend as vet, sekondat janë konë në pyetje, kur dikush prej atyne që kanë provoku hyjnë me veturë brenda në turmën e protestuesve. Edhe aty ma nuk e di çka ka ndodhë, se unë i kam humbë ndjenjat, domethonë kam qenë njëra prej atyne të cilat më kanë shkel me veturë edhe nuk e di, nuk e mbaj në mend ngjarjen më çka ka ndodh aty. Po vetëm kur e kom pa veten në spital, me gips në kambë edhe me njerëz që më kanë shoqëru, që s'i kam njoft, as nuk më kanë njoft po...

Unë diku kam qenë ka mesi i marshit, por si tip sportiv që kam qenë edhe që pak a shumë kam dashtë me bo një kontribut pak ma shumë. I kemi pasë do shirita të kuq që u kujdeshim që turma mos të del jashta, jashta vijës ku u kanë e përcaktume qysh me ecë protestusit. Edhe e kemi pasë na një shirit në dorë që m'u identifikoi, me ditë që deri këtu është vija ku duhet me, me hecë edhe diku ka mesi i turmës kam qenë. E di ja kemi mbajtur edhe dorën njëra-tjetrës që mos të ndahemi. Ka pasë edhe njerëz tjerë afër meje që kanë qenë të përfshimë edhe ata, po rasti im ka qenë ma i randë masi kam pësuar lëndime.

Gjyshen Doko Berisha: Kemi arritë deri te hyrja e Fushë Kosovës, e aty ka pasë polici, por ka pasë provokime gjatë kësaj rruge. Meqë unë në fillim kam qenë nuk kam mund ta shoh, por pastaj prej kryesisë të Forumit të Gruas disa gra kanë qenë të caktuara të rrijnë në rresht deri në fund që ta përcjellin gjendjen. Ka pasë vetura të cilat kanë ardhë dhe kanë, i kanë provoku gratë, bile e kanë lëndu njërin edhe e kanë çu në spital, është nda prej marshimit është dashtë që të dërgohet në spital, provokime të tilla.

Igballe Rexha Jasahri: Unë kom qenë në fillim. Ajo ka ndodhë domethëne kah mesi. Kur kemi dëgju, domethonë ashtu atëherë gjithë masa pak është trazu që çka po ndodhë, çka po dojnë me ba, domethonë edhe... po për fat të mirë s'ka qenë, s'ka ndodhë diçka e keqe, domethonë. Është ngritë ajo gruja, është kthjellë, i kemi, e kemi tërhjekë, domethonë prej rendit po, domethonë s'ka ndodhë diçka ma e keqe. Por, ato kanë qenë të pritshme. Personalisht, po flas për veti, domethonë kanë qenë të pritshme vazhdimisht, të gjitha ato të mundshme që të ndodhin në çdo moment kanë qenë të pritshme. S'ka qenë diçka që ti nuk e pret, që të pret plumbi vazhdimisht, domethonë ajo... por nuk je ndalë.

Kthimi

Albertina Ajeti Binaku: Me të tregu të drejtën ata na kanë përcjellë gjatë tërë kohës, mirëpo deri në një masë, domethonë një pjesë të rrugës, mandej nuk na kanë lanë me shku ma tutje. Nuk na kanë lanë më vazhdu. Na thanë, "Kthehuni, sepse nuk mund të ju sigurojmë që s'do t'ju ndodhë diçka. Osht' luftë, osht'... kanë ndodhë disa gjana..." Për të cilat neve nuk na tregunë çka ka ndodhë, mirëpo ata nuk na lejunë me shku ma tutje. Edhe tha, "Në qoftë se vazhdoni, shkoni në përgjegjësi të ju. Mirëpo, ne nuk mund të ju sigurojmë..." Domethonë që do të vazhdohet deri atje. Po, të njëjtën rrugë jemi kthy, mandej jemi shpërnda. Në të njëjtën rrugë edhe jemi shpërnda. Edhe osht' apeli që m'u shpërnda, mos me nejtë grupe-grupe se mundemi edhe me u burgos edhe me u malltretu edhe...

Flora Brovina: Ne u konsultum njëra me tjetrën e pashë atmosferën që është të kthehemi, të mos rrezikojmë më tutje. Kur u kthym me bukë në dorë vendosëm që bukën pjesërisht ta dorëzojmë në Kryqin e Kuq Ndërkombëtar që ta ngacmojnë, që të ofrojnë ndihmë ktyne popullatës dhe pjesërisht ta dorëzojmë në UNHCR. Realisht ne u kthejshim simbolikisht, sepse realisht ishim në Drenicë, këta desha ta them, na ishim në Drenicë. Më vjen keq t'i përmend disa nga shoqet e mia tani, ndoshta krejt jetën do ta kenë merak pse s'kanë marrë pjesë në demonstratë, por ato ishin realisht në Drenicë.

Edita Tahiri: Motivi parë ka qenë gjendja e randë në Drenicë, pra shtetrrëthimi ushtarak ku popullata vunte për ushqim, për barna, e gjëra tjera. Aty pra idea e parë ishte që të solidarizohemi me Drenicën, në anën tjetër që të rrisim vetëdijen ndërkombëtare që koha është që të ndalet lufta në Kosovë. Menjëherë pas asaj, pas pengesave që na bëri okupatori, pra ne u ballafaquam këtu në Fushë Kosovë drejt për së drejti me forcat policore të Serbisë, u konfrotuam verbalisht. Ne vendosëm që të bëjmë protestën tjetër në mënyrë që të vazhdojmë që përmes zërit të gruas ta bëjmë botën që të reagoj.

Lindita Cena: Kisha këmbën e mobilizume me gips, ka pasë, nuk e harroj që kanë qenë protestat mas kësaj që me çelës, me çelësa me dalë në qytet edhe me i kërsetë çelësat me bo zhurëm. Unë në pamundësi për me dalë në qytet, kam dalë në ballkon të banesës edhe e kam kry atë. S'kam mujt me ndalë vetën, e kemi pasë si në gjak edhe e kemi ditë qëllimin edhe arsyen për çka protestohet edhe u

konë e pamundur me ndalë vetën, edhe nëse une kam dashtë me ndalë vetën nuk... ka qenë e pamundur.

Albertina Ajeti Binaku: Na u pat zhvillu ajo ndjenja e patriotizmit, e ndjenjës që duhet me i ndihmu njeni-tjetrit, e ndjenjës që të gjithë jemi në rrezik jo veç ata, po të gjithë jemi në rrezik. E ndjenjës që dikush i cili ka jetu në vendet rurale ka nevojë për ndihmën e njerezvë të cilët jetojnë në vendet urbane.

Flora Brovina: Demonstratat me letrat e bardha, demonstratat me bukë në dorë, dhe demonstratat për paqen që u mbajtën në Dragodan ma vonë, do të jenë ato që do të kenë jehonë anë e mbanë botës, madje gazetatat e shquara në botë do të shkruajnë dhe do të kenë foto të shumta për ne dhe do të gëzojmë përkrahjen e grave gjithandej botës.